

VENDIM
Nr.88, datë 28.1.2008

PËR MIRATIMIN E NORMAVE TË TRAJTIMIT ME USHQIM TË EFEKTIVAVE
USHTARAKË TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 11, të nenit 14, të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ushtarët e shërbimit të detyrueshëm ushtarak dhe studentët e universitetit ushtarak “Skënderbej” të trajtohen me racionin bazë të ushqimit, i cili përmban 4 300 kalori, dhe me strukturë ushqimore, sipas lidhjeve nr.1 dhe nr.3, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Njësitë e Forcave të Armatosura, gjatë angazhimeve në operacione e stërvitje të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, përveç racionit bazë të ushqimit, të trajtohen me racion shtesë, me 500 kalori, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ministri i Mbrojtjes përcakton dhe miraton:

a) repartet e Forcave të Armatosura, që do të trajtohen me shtesë racioni ushqimor, me 500 kalori për ditë;

b) strukturën e racionit bazë të ushqimit ditor (proteina, yndyra, karbohidrate), në përputhje me kaloritë dhe vlerën financiare;

c) normën e zëvendësimit të artikujve ushqimorë, në përputhje me kaloritë dhe strukturën ushqimore;

ç) trajtimin me ushqim të gatuar, pa pagesë, për oficerët, nënoficerët dhe ushtarët profesionistë, në rast të qëndrimit në repart mbi 8 (tetë) orë, për arsye gatishmërie, shërbimi 24-orësh, apo trajnime dhe stërvitje në terren, në operacione të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. Në këto raste ushtarakët nuk përfitojnë kompensim të ushqimit në vlerë leku;

d) njësitë dhe repartet, që plotësojnë infrastrukturën e nevojshme për kalimin e shërbimit të ushqimit me kontraktorë;

dh) normat e materialeve dhe të pajisjeve për gatim, ruajtje dhe shpërndarje të shërbimit të ushqimit në Forcat e Armatosura.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

5. Vendimi nr.140, datë 11.6.1975 i Këshillit të Ministrave “Mbi normat e ushqimit të kuadrove ushtarake, efektive dhe rezerviste, gjatë stërvitjes luftarake”, shfuqizohet.

6. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes të nxjerrë udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

TABELA E RACIONIT BAZË TË USHQIMIT DITOR NË VLERË KALORIKE

Nr.	Artikulli	Njësia matëse	Sasia me tre vakte	K/Kal me tre vakte
1.	Bukë gruri masive	gr	600	1603
2.	Oriz	gr	60	218
3.	Makarona	gr	50	184
4.	Fasule	gr	60	186
5.	Mish viçi i freskët	gr	200	320
6.	Vaj për gatim	ml	30	270
7.	Vaj për sallatë	ml	10	90
8.	Gjalpë	gr	30	235
9.	Sheqer	gr	50	196
10.	Sallam ose proshutë	gr	50	231
11.	Djathë i bardhë	gr	40	123
12.	Qumësht i freskët	ml	300	183
13.	Vezë	kokrra	1	79
14.	Perime për gatim	gr	350	130
15.	Perime për sallatë	gr	150	60
16.	Fruta të freskëta	gr	250	125
17.	Reçel	gr	30	67
18.	Salcë	gr	3	0
19.	Çaj mali	gr	1	0
20.	Kripë	gr	10	0
21.	Erëza	gr	1	0
	Shuma			4300

Lidhja nr.2

TABELA E ARTIKUJVE USHQIMORË PËR SHITESËN 500 KALORI

Nr.	Artikulli	Njësia matëse	Sasia	K/Kalori
1.	Biskota	gr	50	250
2.	Çokollata	gr	25	104
3.	Vezë	kokrra	1	79
4.	Mish viçi i freskët	gr	42	67
	Shuma			500

Lidhja nr.3

TABELA E STRUKTURËS USHQIMORE NË VLERË KALORIKE PËR VAKTIN E DREKËS

Nr.	Artikulli	Njësia matëse	Sasia me një vakt	K/Kal me një vakt
1.	Bukë gruri masive	gr	200	534
2.	Oriz	gr	50	183
3.	Makarona	gr	50	183
4.	Fasule	=	=	=
5.	Mish viçi i freskët	gr	120	192
6.	Vaj për gatim	ml	15	135
7.	Vaj për sallatë	ml	10	90
8.	Gjalpë	gr	10	75.8

9.	Sheqer	=	=	=
10.	Sallam ose proshutë	=	=	=
11.	Djathë i bardhë	=	=	=
12.	Qumësht i freskët	ml	=	=
13.	Veze	kokrra	1/2	39
14.	Perime për gatim	gr	200	114
15.	Perime për sallatë	gr	150	85
16.	Fruta të freskëta	gr	200	108
17.	Reçel	=	=	=
18.	Salcë	gr	2	=
19.	Çaj mali	=	=	=
20.	Kripë	gr	5	=
21.	Erëza	=	1	=
	Shuma			1738.8